



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-038

Prishtinë, më 4 nëntor 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 4 NËNTOR 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku dhe Xhezair Murati, ndërsa munguan (me arsye) Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Sllobodan Petroviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Arsim Avdiaj, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga NDI: Rinor Beka dhe

Nga OSBE: Lejlja Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 tetor 2008,
2. Shqyrtimi i çështjes së ndërtimit të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi,
3. Konfirmimi i Vendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri... për lejimin e mjeteve financiare për punë brenda apo jashtë vendit për rihartimin e Ligjit për Shpronësim nr. 02/L-97,
5. Kërkesa shtese për procedim te Projektligjit për te drejtat e ish te burgosurve politik
6. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për lejimin e udhëtimit jashtë Vendit,
7. Konfirmimi i Vendimit për ndarjen e hapësirave Ministrisë se transportit dhe telekomunikacionit ne Anexin e ndërtesës së Kuvendit
8. Shqyrtimi i kërkesës së ish-deputetit Ramadan Kelmendi për ndihmë financiare për shërim,
9. Njoftimi i KPM-së me Listën e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së,
10. Njoftimi lidhur me zbatimin e Vendimit te Kryesise per ndarjen e mjeteve per financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, dhe
11. Njoftimi nga Grupi Joformal i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës për udhëtim në Kroaci me datën 09-10 nëntor 2008.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 tetor 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 tetor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i çështjes së ndërtimit të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi

Kryesia shtyu këtë pikë për mbledhjen e ardhshme me arsyetimin se nuk ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kryesisë.

3. Konfirmimi i Vendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Kryesia, njëzëri konfirmoi vendimin për udhëtime zyrtare jashtë vendit, si vijon:

V E N D I M

I. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit lejohen në përputhje me kushtet dhe kriteret, në vijim:

1. Ftesa për udhëtime zyrtare jashtë vendit të jetë e adresuar në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune para datës së udhëtimit.

2. Ftesa me agjendë dhe kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar jashtë vendit evidencohet në Shërbimin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Protokoll, i cili të njëjtën ia procedon për shqyrtim Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit.
3. Komisioni për Punë të Jashtme vlerëson ftesën dhe kërkesën nëse udhëtimi zyrtar ka të bëjë me përfaqësimin e Kuvendit dhe të trupave punues të tij dhe nëse ka të bëjë me bashkëpunimin ndërparlamentar.
4. Komisioni për Punë të Jashtme, pasi ta vlerësojë arsyeshmërinë e udhëtimit zyrtar, i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të marrë vendim në lidhje me të.
5. Shpenzimet e udhëtimit të jenë në përputhje me shumën e mjeteve të caktuara nga Qeveria e Kosovës për të gjitha organet shtetërore, për secilin vend të udhëtimit, ndërsa kur shpenzimet e udhëtimit i bartë organizatori - nikoqiri, pjesa shtesë e mëditjeve të jetë 30% nga shuma e përgjithshme e mëditjes.
6. Udhëtimin zyrtar të nëpunësve të Administratës së Kuvendit, me propozimin e Sekretarit, e lejon Kryetari i Kuvendit.
7. Me miratimin e këtij vendimi shfuqizohet çdo vendim tjetër që është në kundërshtim me të.
8. Ngarkohet sekretari i Kuvendit ta zbatojë këtë vendim.
9. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri... për lejimin e mjeteve financiare për punë brenda apo jashtë vendit për rihartimin e Ligjit për Shpronësim nr. 02/L-97

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta specifikojë kërkesën për lejimin e mjeteve financiare, si dhe numrin e anëtarëve të Grupit të Punës për të marrë pjesë në rihartimin e Ligjit për shpronësim, në ndonjë vend brenda Kosovës.

5. Procedimi i Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politik

Kryesia lidhur me procedimin e këtij Projektligji, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për të drejtat e ish të burgosurve politikë të procedohet në pajtim me Rregullën 33 të Rregullores së Punës së Kuvendit .
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa ndërkohë duhet ta vlerësojë Deklaratën për implikimet buxhetore për zbatimin e tij.

6. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për lejimin e udhëtimit jashtë vendit

Kryesia lejoi udhëtimin e anëtarëve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Hungari prej 10 deri më 13 nëntor 2008.

7. Konfirmimi i Vendimit për ndarjen e hapësirave Ministrisë së transportit dhe telekomunikacionit në Anësin e ndërtesës së Kuvendit

Kryesia konfirmoi vendimin e mëhershëm për lirimin e hapësirave të ndërtesës së Kuvendit në katin e tretë nga ana e Ministrisë së transportit dhe telekomunikacionit dhe vendosjen e saj të përkohshme në anësin e tjetër.

8. Shqyrtimi i kërkesës së ish-deputetit Ramadan Kelmendi për ndihmë financiare për shërim

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

REKOMANDIM

Kryesia e Kuvendit vlerëson lart kontributin e ish – deputetit Ramadan Kelmendi gjatë legjislativave të mëparshme dhe shpreh gatishmëri për t’i ndihmuar në situatën në të cilën gjendet. Por, në mungesë të mjeteve nga ndonjë linjë buxhetore për këtë destinim, i **rekomandohet** Ministrisë së Shëndetësisë që t’ia kompensojë shpenzimet e shërimit ish – deputetit Ramadan Kelmendi.

9. Njoftimi i KPM-së me Listën e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së

Kryesia, pasi u njoftua me propozimin e Komisionit Ad Hoc, nxori këtë

PËRFUNDIM

1. Kërkohet nga partitë politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, që ta dërgojnë nga një anëtar në Komisionin Ad Hoc për të shqyrtuar listën e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Bordit të RTK-së.
2. Komisioni ad Hoc duhet që Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në pajtim me nenin 23.2 të Ligjit për Radio - Televizionin e Kosovës.

10. Njoftimi lidhur me zbatimin e Vendimit të Kryesisë për ndarjen e mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvend

Kryesia, pasi u njoftua me kërkesat për zbatimin e vendimit për ndarjen e mjeteve për financimin e partive politike, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ndarja e mjeteve për financimin e partive politike, të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, për vitin 2008, të bëhet mbi bazën e Vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr.03/0220/DO-18, datë 10 mars 2008.

11. Kërkesa e sekretarit të Kuvendit për ridestinimin e mjeteve për investime kapitale

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e sekretarit, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e sekretarit të Kuvendit që 15% nga shuma e mjeteve të parapara për investime kapitale, siç janë:

1. Ndërrimi i Fasadës	150.000.00 €
2. Ndërrimi i dyerve dhe dritareve	200.000.00 €
3. Renovimi i tualeteve	195.000.00 €
4. Pajisjet për Video - Konferencë	25.000.00 €
5. Rregullimi i Oborrit	25.000.00 €

Të transferohen në këto projekte:

1. Furnizimi me Desk Top Kompjuterë për stafin e Kuvendit të Kosovës 25.000€.
 2. Realizimi i aneks kontratës për Trafostacionin e ri në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës 6.299.73€.
 3. Pjesa tjetër të transferohet në kategorinë e mallrave dhe të shërbimeve.
2. Të kërkohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të bëjë transferin e mjeteve sipas kërkesës së cekur në paragrafin një (1) të këtij vendimi.

12. Njoftimi nga Grupi joformal i grave deputete të Kuvendit të Kosovës për udhëtim në Kroaci me datën 09-10 nëntor 2008

Kryesia u njoftua për udhëtimin e Grupit joformal të grave deputete në Kroaci.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale